



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria e Arsimit

24.08.2022

Nr.07-Zyrtarisht

Në bazë Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit për Arsimin në Komunitet në Republikën e Kosovës, Nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr. 02/2016, neni 11 dhe kërkesave të SHML-së dhe IAAP-së, Drejtoria Komunale e Arsimit në Deçan shpallë këtë:

FTESË PËR OFERTË

Për organizimin e Ekskursioni në Shqipëri, më maturan të dy shkollave të mesme të larta:

1. SHML- Gjumnazi - "Vëllezërit Frashëri" në Deçan;
2. IAAP - "Tafil Kasumaj" në Deçan.

Ekskursioni do të jetë pesë ditë kalendarike (pesë bujtje).

Agjensioni duhet të plotësojë këto parakushte:

1. Të ketë licencë valide;
2. Të ketë kontroll teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore;
3. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e nxënësve;
4. Autobusët të jenë komfor dhe më klimë;
5. Të mos ketë referenca negative;
6. Të ofrojë dëshmi për shëndetin fizikë dhe mendor të ngasësve të autobusëve;
7. Të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe dëshmi (certifikatë pune si dhe diplomë të mjekut të angazhuar);
8. Agjensioni është i obliguar të zbatojë itinerarin e caktuar të ekskursionit;
9. Të posedojë dokumentacionin (licencë), e agjencionit të akreditimit të ushqimeve për vendqëndrimin e nxënësve;
10. T'i mbulojë shpenzimet e kujdestarëve të klasave dhe shpenzimet e vizitave të nxënësve në monumente historike;
11. Ekskursioni do të zhvillohet në shtetin shqiptar, pikë qëndrimi do të jetë Durrësi;
12. Do të ofrohen tre shujta ditore (mëngjes, drekë dhe darkë);
13. Do të vizitohen këto qendra: Shkodra, Lezha, Tirana, Kruja, dhe Berati – (Gjumnazi);
14. Do të vizitohen këto qendra: Kruja, Durrësi, Berati, Tirana, Lezha. – (IAAP).

Ofertuesi ka për obligim të përcaktojë se për cilën shkollë oferton.

Oferta do të shqyrtohet për secilën shkollë në mënyrë të veçantë, pa u ndikuar nga ofertat e shkollave tjera, objekte të kësaj oferte.

Kriteret për përzgjedhjen e kompanisë janë të përcaktuara në bazë të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr. 02/2016.

Kompanitë fituese, do të monitorohen nga DKA-ja.

Afati i ofertës është 7 ditë, nga dita e shpalljes.

Ofertat protokollohet në zyrën pritëse, dhe dorëzohen në zarfe të mbyllura (personalisht), në zyrën e DKA-së në katin e parë.

Hapja e ofertave bëhet më datë 01.09.2022 në shkollat përkatës, për orar ju njoftojmë më kohë.

